



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 345 4 Më 16.09.2026
Br. prct. 16.09.2026
RAHOVEC - ORAHOVAC

THIRRJE PËR APLIKIM

PÛRKRAHJA E FERMERËVE ME SERRA

Njoftohen fermerët e komunës së Rahovecit se Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në kuadër të programit për zhvillimin e bujqësisë për vitin 2026, ka paraparë që të bëjë ndërtimin e Serrave me participim për kultivuesit e perimeve si dhe të instalojë sistemin vetmenagjues modeli EPSA (smart serra).

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e serrës 3 dhe 5 ari janë:

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të ketë të shlyera obligimet ndaj Komunës (vërtetim i tatimit në pronë),
- Të jetë kultivues i perimeve,
- Të jetë i gatshëm të nënshkruaj marrëveshje me Komunën e Rahovecit dhe të merr përsipër participimin prej 20%

Kriteret specifike që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e serrës 3 dhe 5 ari janë:

Përveç kushteve të përgjithshme, fermerët duhet të plotësojnë edhe këto kritere specifike:

- Të jetë aplikues në Programin e Pagesave Direkte – Subvencione në vitin 2026
- Të ketë së paku **0.30 ha** të mbjellura me kultura Perimore (spec, domate, tranguj, lakër, marulla, spinaq etj.).
- Të kenë qasje në sistem të ujitjes, apo të kenë të siguruar burime alternative të ujit.
- Nuk kanë të drejtë përfitimi fermerët dhe anëtarët e ngushtë të bashkësisë familjare, të cilët kanë përfituar serrë në tri (3) vitet e fundit.

Përparësi në përzgjedhjen e fermerëve përfitues të serrave 3 ari, 5 ari dhe sistem smart.

- Fermerët me sipërfaqe më të madhe në raport me ata që kanë sipërfaqe më të vogël të mbjellë me perime (spec, domate, tranguj, lakër, marulla, spinaq etj.).
- Përparësi kanë gratë fermere dhe fermerët e ri (18-29 vjet)
- Në kushte të barabarta, përparësi përfitimi kanë fermerët dhe anëtarët e ngushtë në bashkësi familjare, të cilët nuk kanë qenë asnjëherë përfitues nga komuna.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

- Fleta poseduese e tokës - çertifikata e pronësisë,
- Kopja e planit të parcelës ku do të vendoset Serra,
- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës,
- Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë.

Karakteristikat e përgjithshme për Serra:

1. Serra 300m², 50 copë
2. Serra 500m², 20 copë
3. Sistemi vetmenagjues modeli EPSA (mekanizëm smart) – 8 copë

Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë fermerët për përfitimin e sistemit vetmenagjues (mekanizimit smart të serrës).

- Të jetë banor i Komunës së Rahovecit,
- Të jetë fermerë i regjistruar (NIF)
- Të ketë të shlyera obligimet ndaj Komunës (vërtetim i tatimit në pronë),
- Të jetë kultivues i perimeve dhe të ketë minimumi 0,10 ha serrë të pandarë.
- Të jetë i gatshëm të nënshkruaj marrëveshje me Komunën e Rahovecit dhe të merr përsipër participimin prej 20%
- Të jetë i gatshëm të prodhojë produkte BIO në serrë sipas standardeve të BE-së (pa përdorimin e pesticideve dhe plehrave artificial).

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim për mekanizimin smart të serrës.

- Fleta poseduese e tokës - certifikata e pronësisë,
- Kopja e planit të parcelës ku do të instalohet sistemi vetmenagjues (mekanizmi smart),
- Kopja e letërnjoftimit të vlefshëm të Republikës së Kosovës,
- Dëshminë mbi pagesën e tatimit në pronë.
- Fotografinë e serrës ekzistuese që aplikon për sistemin vetmenagjues.

Vërejtje:

- *Përkrahja do të jetë 80% nga Komuna e Rahovecit,*
- *Të jenë të gatshëm të kryejnë pagesën prej 20%*
- *Verifikimi i përzgjedhjes së përfitueseve do të bazohet në aplikacionet për Pagesa Direkte të vitit 2026, dhe në kriteret e përgjithshme, specifike dhe përparësitë e cekura më lart në thirrje.*
- *Përdorimi i pesticideve të jetë me standarde të BE-së dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë.*
- *Të ket rrjet të rrymës afër serrës ose sistem solar me së paku 3.5 kw për aplikuesit e smart serrave.*

Përzgjedhjen do ta bëjë komisioni i formuar pas mbylljes së afatit të aplikimit dhe do të formohet nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Afati i aplikimit nga data: **16.09.2026** deri më **30.09.2026**

Aplikacionet dorëzohen në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Drejtori për BPZHR

Behar Thaqi

